



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-84
Prishtinë, më 17 nëntor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi dhe Myfera Shinik, anëtarë të Kryesisë.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga NDI, Petrit Hysa dhe Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe një pikë shtesë: - Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore për caktimin e pagave të aëtarëve të Këshillit.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 nëntor 2009,
2. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 nëntor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 nëntor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

2.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Et'hem Çeku për lejimin e pjesëmarrjes në Samitin Evropian për Strategjinë e Energjetikës, në Pragë – Republika e Çekisë, nga 30 nëntor deri më 2 dhjetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk mund të bartë shpenzimet e pjesëmarrjes, të qëndrimit dhe të udhëtimit për pjesëmarrje të deputetit Et'hem Çeku në Samitin Evropian për Strategjinë e Energjetikës, që do të mbahet në Pragë, Republika e Çekisë prej 30 nëntor deri më 2 dhjetor 2009.

2.2 Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të këtij komisioni në Republikën e Polonisë, nga 1 deri më 4 dhjetor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve: Ismet Beqiri, Hajredin Hyseni, Radmilla Vujoviç, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Sanije Aliaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati, si dhe dy zyrtarëve të Administratës së Kuvendit: Rrahim Demaj dhe Visar Krasniqi, në Poloni, prej 1 deri më 4 dhjetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i bart organizatori, kurse mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

2.3 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Synavere Rysha për shqyrtimin e Vendimit nr. 03-V-185, të datës 1 korrik 2009

Kryesia pasi shqyrtoi pikë të rendit të ditës, mori këtë

V E N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk miratoi kërkesën e deputetes Synavere Rysha për rishqyrtimin e Vendimit nr. 03-V- 185, të datës 1 korrik 2009, përkatësisht konfirmoi vendimin e mëparshëm.

Pika shtesë

Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore për caktimin e pagave të aëtarëve të Këshillit

Kryesia, pasi shqyrtoi pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa që të shqyrtojë dhe të vendos për kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur me pagat për anëtarët e këtij Këshilli.

3. Të ndryshme

3.1 Njoftimi për vizitë zyrtare në Hungari

Kryetari e njoftoi Kryesinë se një delegacion i Kuvendit pritet t'a realizojë një vizitë zyrtare në Hungari, në fund të këtij muaji. Për hollësitë e tjera Kryesia do të njoftohet me kohë.

3.2 Shqyrtimi i ftesës së Kryetares së Parlamentit të Shqipërisë për vizitë zyrtare të delegacionit parlamentar të Kuvendit të Kosovës, në Shqipëri

Kryesia pasi shqyrtoi pikë të rendit të ditës mori këtë

V E N D I M

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**